

Lënda: Kthim përgjigje

KUVENDIT

Për dijeni: Z. Kastriot Kasa

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të regjistruar me nr. 2274 prot, datë 20.03.2022, ju sqarojmë si më poshtë:

Referuar sistemit të pagesave të pensioneve PCAMS, nuk rezulton asnjë qytetar me gjeneralitetet Kastriot Sefer Kasa që të jetë përfitues i ndonjë pensioni nga skema e sigurimeve shoqërore.

Bazuar në nenin 31, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: *personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92 të po këtij ligji.*

Lidhur me pretendimin e z. Kasa për mos marrje të ndihmës ekonomike, bazuar në VKM nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kritereve të procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike” duhet të drejtohet pranë Shërbimit Social Shtetëror pasi nuk është kompetencë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.